



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.46, datë 27.07.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“STRUKTURË TURISTIKE “HEL-PET” 2, 3 DHE 4 KATE, ME 1 KAT NËNTOKË DHE  
ME PISHINË”, ME VENDNDODHJE NË RADHIMË, BASHKIA VLORË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërinë “Hel-Pet” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Strukturë turistike “Hel-Pet” 2, 3 dhe 4 kate, me 1 kat nëntokë dhe me pishinë”, me vendndodhje në Radhimë, Bashkia Vlorë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Hel-Pet” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJES

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

